



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:281359
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06155169

C.nr.483/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen juridike civile kontestimore të paditësit F.O. nga P. Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson B.I.avokat në Gjilan, kundër të paditurve A.O., B.O.dhe D.O., të gjithë nga P., për vërtetimin e drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, jashtë seancës gjyqësore me datë 12.09.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPREHET procedura kontestimore e paditësit F.O. nga P. Komuna e Vitisë, kundër të paditurve A.O., B.O.dhe D.O., të gjithë nga P., pas vdekjes së paditësit F.O. i cili ka vdekur me datë 25.08.2020 në P..

A r s y e t i m

Paditësit F.O. nga P. Komuna e Vitisë, përmes padisë së ushtruar më datë 02.11.2018, ka kërkuar nga gjykata tia vërtetohet të drejtën e pronësisë në bazë të trashëgimisë, duke i paditur A.O., B.O.dhe D.O., të gjithë nga P..

Gjykata ka mësuar se paditësi F.O.nuk është më në jetë, i cili ka vdekur me datë 25.08.2020 në fshatin e tij të lindjes në P., andaj ka kërkuar informatën nga Zyra e Gjendjes Civile në Viti, nga e cila është njoftuar se paditësi F.O., ka vdekur me datë 25.08,2020 në P. të Vitisë, nga e cila zyrë ka pranuar edhe provën, respektivisht certifikatën e vdekjes me nr. serik V 10712156 , me nr. rendor 143, e datës 12,09.2024, nga regjistri i të vdekurve, me të cilën vërtetohet se ky paditës ka vdekur me datë 25.08.2020 në P..

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të ndërpritet procedura kontestimore, për shkak të vdekjes së paditësit.

Pasi që gjykata ka kosntatuar se paditësi F.O.ka vdekur, në bazë të nenit 277, paragrafi 1. pika a) të LPK-së, ka ndërprerë procedurën dhe ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C. nr.483/2018

Më:12.09.2024

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 15 ditë pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.